



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni per Ceshtjet Kushtetuese dhe Ligjore

RELACION

PER DEKRETIN NR. 4188 DATE 05.04.2004 TE PRESIDENTIT TE REPUBLIKES PER RISHQYRTIMIN E LIGJIT NR. 9206 DATE 15.03.2004 “ PER NJE SHTESE NE LIGJIN NR. 8461, DATE 25.02. 1999 “ PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.9120 DATE 28.07.2003”.

Komisioni Ceshtjeve Kushtetuese dhe Ligjore ne mbledhjen e tij te dt. 07. 06. 2004, mori ne shqyrtim Dekretin e Presidenit te Republikes per rishqyrtim te Ligjit Nr.9206 date 15.03.2004, “Per nje shtese ne ligjin Nr.8461 date 25.02.1999 “ Per arsimin e larte ne Republikën e Shqiperise ” dhe ndryshuar me ligjin Nr.9120 dt.28.07.2003 ”.

Gjate diskutimit te Dekretit te Presidentit te Republikes dhe njohjes se arsyeve te kthimit te ligjit, Komisioni vlersoi se kthimi i ligjit ne pergjithesi eshte i drejte. Per kete arsye Komisioni u perpoq te gjente nje zgjidhje te pershtatshme dhe balance te drejte ndermjet qellimit te ligjvenesit dhe motivimit te dekretimit te Presidentit per rikthimin per rishqyrtim te ligjit te siperpermendur ne Kuvend.

Per te mos patur nje perplasje te mundeshme midis nenit 18 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise dhe ligjit ,per te eleminuar pabarazine e krijuar me ligje, nga ana e Komisionit u mbajt parasysh qe ne riformulimin e ri te ruhej e pa prekur Kushtetuta.

Po keshtu Komisioni vleresoi si te drejte edhe arsyetimin ne dekret te fatures financiare qe mund te sillte ky ligj dhe per kete arsye u diskutua ky problem me Keshillin e Ministrave te cilet ne pergjigjen e kthyer Komisionit u shprehen dakort me miratimin e ketij ligji.

Ne perfundim te diskutimit Komisioni njezeri i propozan seances plenare miratimin e ketij ndryshimi.

Neni 1 riformulohet ne kete menyre : Ne Ligjin 8461,date 25.02.1999, “ Per arsimin e Larte ne Republikën e Shqiperise”,ndryshuar me Ligjin Nr.9120,date 28.07.2003.ne nenin 28,pas fjalise se pare te paragrafit te pare te shtohet:

“ Personeli akademik i brendshem me titullin “ profesor ” sherben ne detyre deri ne moshen 68 vjec, me perjashtim te rastit kur me kerkesen e tyre lirohen nga detyra per arsye te plotesimit te moshes se pensionit sipas neneve 31 dhe 92 te Ligjit Nr.7703 date 11.05.2003,” Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise. i ndryshuar.

Kjo dispozite ka efekt vetem per subjektet e mesiperme qe kane mbushur moshen e pensionit por jo mbi 68 vjec ”.

Neni 2 “Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.”

Kryetari

Spartak Braho

